



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMITNr. 430/1 ProtTiranë, më 30.1.2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës tuaj

## QENDRËS RES PUBLICA

Tiranë

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është depozituar kërkesa juaj për informacion administruar me tonën nr. 430 Prot., datë 27.01.2025 dhe regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të Zyrës së Komisionerit me nr. rendor 03, datë 27.01.2025.

Në lidhje me pyetjen e parë, mbi numrin e ankesave që ka marrë Zyra e Komisionerit për vitin 2024 në zbatim të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar ju informojmë se gjatë kësaj periudhe u administruan **939 ankesa**, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të **86 procedurave të mbartura nga viti 2023** (gjithsej 1025 ankesa).

Nga totali prej **1025** ankesash, për **623** prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Ndërkohë, institucioni është shprehur me **22** vendime për 23 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë **11** vendime urdhërimi për dhënie informacioni, **5** vendime rrëzimi, **2** vendime mospranimin dhe **4** vendime me sanksion administrativ. Me ndryshimet e LDI, Zyra e Komisionerit ka dalë me **1** vendim për moszbatim vendimi duke sanksionuar titullarin e një AP për mos zbatimin e vendimit të Komisionerit. (Kjo vendimmarrje mund të konsultohet në linkun <https://idp.al/vendime-2024/>).

Ndërkohë, **204** ankesa kanë rezultuar jashtë objektivit, të cilat rezultojnë për çështje me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Gjithashtu, rezultojnë **14** ankesa të refuzuara bazuar në kufizimet e ligjit, **100** ankesa janë jashtë afatit, **25** të paplota, si dhe **36** të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2025.

Për sa i përket pyetjes së dytë, mbi numrin e ankesave nga ana e gazetarëve dhe vendimmarrjes së Zyrës së Komisionerit, ju informojmë se gjatë vitit 2024, për aq sa mund të evidentojmë, rezultojnë të depozituara rreth **365** ankesa nga gazetarë. Për **283** ankesa, gazetarët kanë marrë përgjigje menjëherë pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Për ato raste që autoritetet publike edhe pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, kanë refuzuar të vendosin në dispozicion informacionin e kërkuar, Komisioneri është shprehur me **8** vendime për 9 ankesa.

